

ANALIZË

Media dhe kultura

Nëntor 2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

ANALIZË

Media dhe kultura

Autore:
Besa Luci



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



I. Përmbledhje e përgjithshme

Deri më sot, mediet e lajmeve dhe sektori i kulturës kryesisht janë trajtuar ndarazi nëpër hulumtime dhe studime të ndryshme në Kosovë. Mediat e lajmeve trajtohen brenda kornizave që i matin treguesit e mjedisëve të mediave të lira dhe lirisë së shprehjes, ndërsa prodhimi kulturor ka qenë temë e më pak hulumtimeve, dhe studimet ekzistuese në përgjithësi janë përqendruar në politikat shtetërore për kulturën, ndarjet buxhetore apo në shqyrtimet e mundësive të përgjithshme të prodhimeve kulturore.

Me qëllim të plotësimit të zbrazëtirës së cekur më lartë, përmes këtij raportiparaqitet një pamje e përgjithshme e asaj që e ka formësuar dhe ndikuar qasjen e mediave drejt aktiviteteve kulturore në kuadër të procesit të shtetndërtimit gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të fundit në Kosovë. Andaj, qëllimi i këtij raporti është, që në njërin anë të shqyrtohet se si raportet politike, ekonomike dhe shoqërore, si dhe tregimet e identitetit, ndikojnë në bashkëveprimin mes mediave të lajmeve dhe kulturës në Kosovë

dhe, në anën tjetër, të ofrojë disa shembuj të praktikave dominuese të mënyrave në të cilat mediat e lajmeve të Kosovës i prezantojnë produksionet dhe aktivitetet kulturore.

Në raport janë identifikuar pesë kuptime dhe praktika të përgjithshme të mbulueshmërisë së kulturës nga mediat e Kosovës. E para është interesi i ndërmjetësuar politik, proces ky përmes së cilit aktivitetet kulturore janë zvogëluar në masë të konsiderueshme në proceset e shtetndërtimit, ku, mediat rrallë i përkufizojnë aktivitetet kulturore si temë esenciale për “interesin publik”. Praktika e dytë bazohet më shumë në “gazetarinë protokollare” që nënkupton se konferencat dhe kumtesat për shtyp janë raportimet e kulturës, të cilat rrallëherë kërkojnë debate apo trajtime kritike të ngjarjeve, punimeve, politikave, etj. Praktika e tretë e identifikuar si tendencë në rritje për t’ua atribuuar arritjet kolektive artistëve dhe akterëve kulturorë, duke e konsideruar kështu prodhiminkulturor si fuqi të lehtë apo diplomaci kulturore në emër të tërë shtetit të Kosovës. Në

kuadër të kësaj praktike, punimet kulturore bëhen të vlefshme vetëm kur vlerësohen apo njihen ndërkom-bëtarisht. Praktika e katërt e konsideron rolin e mediave të lajmeve si “kujdestar”, duke siguruar që politikat shtetërore për kulturën të caktohen jo vetëm për lehtësimin e fuqizimit të institucioneve publike, si dhe atyre të pavarura, por edhe për të përfaqësuar zëra të ndryshëm. Thuhet se “kujdestari” në politikën e kulturës në përgjithësi mungon, dhe zgjohet vetëm në rastet që kanë prospekte të ‘skandaleve’ –duke i kufizuar politikat në aspektin e kontesteve apo konflikteve personale dhe duke e anashkaluar çështjen në fjalë. Dhe në fund, praktika e pestë i referohet mënyrave në të cilat mediat mund të marrin një rol më vendimtar për të siguruar cilësi më të lartë dhe më shumë mbulueshmëri të aktiviteteve kulturore, përfshirë programet edukative. Të gjitha këto praktika janë më gjerësisht të elaboruara në pjesën e katërt të këtij raporti.

Në pjesën e parë të raportit është dhënë një hyrje në kornizën teorike,

brenda së cilës është i vendosur ky studim. Kjo kornizë i thekson disa nga konceptet kryesore të politikës së përfaqësimit dhe mediave si ideologji, dhe i shqyrton kryqëzimet e prodhimit kulturor me ekonominë politike, si dhe kufizimet financiare shkak të presioneve të tregut mbi mediat informative. Qëllimi i kësaj pjese është që të paraqitet nevoja për një perspektivë më të gjerë brenda së cilës mediat dhe kultura mund të diskutohen në përgjithësi.

Duke pas parasysh që konceptet e diskutuara në pjesën hyrëse mund të elaborohen ndarazi në hulumtime të tjera, brenda fushëveprimit të këtij raporti, pjesa e dytë ofron vetëm definicione dhe analiza që kanë të bëjnë me mediat dhe kulturën. Andaj, mediat do të kufizohen me mediat e lajmeve; do të përqendrohet në ciklin e prodhimit të informatave përmes prizmit të gazetarisë, dhe mënyrës se si ato e përcjellin lajmin tek publiku i gjerë. Kultura do të trajtohet përmes dy lidhjeve të kryqëzore. Njëra ka të bëjë me prodhimin e aktivitetit kulturor përmes përzgjedhjes dhe pro-

movimit mediatik, dhe tjetra është mënyra me të cilën ato aktivitete, në veçanti tekstet mediatike, bëhen artefakte kulturore.

Në pjesën e tretë do të jepet një pamje më e qartë e zhvillimit të mediave në Kosovë, dhe do të jetë perspektiva kryesore përmes së cilës do të analizohet mbulueshmëria mediatike e kulturës në këtë raport. Këtu përfshihet një vështrim në atë se si zhvillimi i mediave, si pjesë e diskursit të 'demokracive në tranzicion', proceseve të shtetndërtimit dhe të presioneve të vazhdueshme dhe në rritje të tregut, kanë ndikuar në kuptimin, praktikat dhe vendosjen e kulturës brenda mediave kryesore të Kosovës.

Në fund, ky raport ofron një skicë të disa prej çështjeve kryesore që e karakterizojnë raportin mes mediave dhe kulturës në Kosovë, dhe si e tillë ka për qëllim që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të perspektivave dhe trendëve interesant që mund të merren për analiza më të thella në të ardhmen.

I. HYRJE

vështrim mbi kornizën teorike

Raporti mes mediave dhe kulturës ka qenë fushë e eksplorimeve dhe hulumtimeve të vazhdueshme në disiplinat e shkencave humane dhe atyre sociale. Studimet mbi mediat dhe kulturën filluan kryesisht në fillim të shekullit të 20-të, kur pas 500vitesh të mediave të shtypura si mas media kryesore e informimit, përparimi teknologjik bëri që të zhvilloheshin mas media të tjera, si radio, televizioni, filmi, pajisjet digjitale, duke mundësuar kështu prodhimin dhe konsumin në masë të kulturës.

Si të tilla, konceptet e mas mediave dhe mas kulturës u bënë bazë për një varg analizash kritike, që kërkojnë të ofrojnë vështrim teorik dhe kritik ndaj kryqëzimit të komunikimit, pushtetit dhe domethënies. Në analizën kulturore, pati pyetje rreth rolit transformues të kulturës dhe artit në shoqëri, veçanërisht nga fakti se përmes kanaleve të mas mediave, produktet kulturore me shpejtësi dhe gjithnjë e më shumë shndërroheshin në produkte komerciale. Nga ana mediatike e barazisë, meqë dolën medime të ndryshme,

informatat mund të prezantoheshin në forma dhe formate të ndryshme, duke i drejtuar kështu diskutimet se si forma dhe formati ndikojnë në domethëniet që i komunikojnë tekstet mediatike. Në të dyja rastet, aspekt domethënës ishte pozita dhe roli i audiencës (publikut) – në atë se si publiku përkufizohet, shenjëstrohet, adresohet dhe përfshihet në proces. Sot, që jemi në shekullin 21, në të ashtuquajturën epokën e informacionit, këto diskutime janë të pashmangshme.

Në kuadër të këtyre konteksteve, fusha e studimeve mediatike dhe kulturore ka dalë si disiplinë e rëndësishme, duke huazuar nga teoritë dhe kritikën sociale të disiplinave të ndryshme. E përkufizuar ndarazi, fusha e studimeve mediatike në përgjithësi merret me “përmbajtjen, formën, historinë, efektet, dhe implikimet politike të mediave dhe teknologjive të ndryshme,”¹e përqendruar kështu në mas

1 Cultural and Media Studies. TheNewSchool, EugeneLang College. www.newschool.edu/uploadedFiles/Lang/Documents/sp13-lang-culture-and-media-slideshow.ppt. Qasur së fundi më 30 janar 2016.

mediat në shoqëritë bashkëkohore. Ndërsa, studimet kulturore, që bazohen në teori kritike, në përgjithësi kanë të bëjnë me “natyrën politike të kulturës së famshme bashkëkohore”²dhe përqendrohet në mënyrën se si ndonjë medium specifik apo porosi specifike ndërlidhet me ideologjinë, identitetin, klasën sociale, përkatësinë kombëtare, përkatësinë etnike, gjininë, etj. Nëse trajtohen bashkërisht brenda studimeve mediatike dhe kulturore, përqendrimi kalon tek kuptimi i proceseve të ndërmjetësimit.

Duke qenë të tilla, këto korniza teorike përbëjnë themel mbi të cilin analiza e teksteve aktuale mediatike (informim dhe komunikim duke filluar që nga shtypi, filmi, televizioni, radio, dhe interneti)mund të kuptohet në një kontekst më të gjerë të politikës, ekonomisë, arsimit, artit, argëtimit, teknologjisë, etj. Njëkohësisht, përmes këtyre kornizave, tekstet mediatike mund të shikohen si tekste kulturore në vetvete, meqë domethëniet e tyre flasin për mënyrat në të cilat sistemet e vler-

2 Po aty 1.

8 • MEDIA DHE KULTURA

ave dhe të besimeve janë të formësuara, ndërtuara dhe fuqizuara. Shpesh ndodhë që ndaj mediave dhe kulturës të bëhen analiza politiko-ekonomike, të cilat më shumë përqendrohen në “prodhimin dhe shpërndarjen e argëtimit, reklamave, lajmeve dhe informatave, sesa në interpretimin e teksteve apo në studimin e audiencave.”³Në kuadër të këtij raporti është bërë përpjekje për të shtjellohen të dy perspektivat analitike.

Deri më sot, në Kosovë mediat dhe kultura në përgjithësi janë trajtuar ndarazi. Hulumtimet aktuale rreth mediave në Kosovë në masë të madhe dominohen prej studimeve sasiore dhe pozitiviste të kryera nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Kultura kryesisht është trajtuar përmes analizave të planifikimit shtetëror dhe fokusit në politikat kulturore dhe në ndarjet buxhetore për kulturën. Pak hulumtime janë bërë rreth marrëdhënieve mes mediave dhe kulturës përmes stu-

3 “Media and Cultural Studies.” Edited by Meenakshi Gigi Durham and Douglas M. Kellner, Second Edition. Wiley-Blackwell. 2012.

dimit të kuptimeve dhe praktikave, në kuadër të raporteve politike dhe ekonomike, duke e marrë parasysh edhe shoqërinë që gjithnjë e më shumë po dominohet nga tregu, udhëhiqet nga informatat dhe nga teknologjia. Natyrisht se ka përrjashime sa i përket hulumtimeve akademike, por ato nuk trajtohen këtu.

Për më tepër, çdo hulumtim apo studim në Kosovë duhet të ketë parasysh se gjatë 30 viteve të fundit, shteti ka kaluar nëpër katër sisteme të ndryshme politike dhe shoqërore: sistemi socialist i viteve 1945-1990, ish-regjimi jugosllav i viteve 1990-ta, protektorati ndërkombëtar nëntëvjeçar i OKB-së, i përcjellë me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008.⁴ Posaçërisht gjatë 16 viteve të kaluara, dhe tetë viteve të fundit pas pavarësisë, është prodhuar një diskurs i posaçëm rreth “tranzicionit” ku proceset e shtetndërtimit shikohen si të varura vetëm nga

fuqizimi i sundimit të ligjit, zhvillimi ekonomik, qeverisja e mirë, si pjesë e reformave të përgjithshme demokratike. Ndonëse mediat janë parë si kyçe për proceset e demokratizimit, kultura është zbritur në një aktivitet që ka pak domethënie për mirëqenien e shoqërisë dhe ndryshimet e ashtuquajtura sistematike më të mëdha.

Në ndërkohë, në kuadër të vet mediave, në sipërfaqe lehtë mund të duket se në Kosovë mbulueshmëriamediatike e kulturës është duke u zhvilluar mirë. Të gjitha mediat e shtypura kanë rubrikat e kulturës, dhe disa kanë edhe shtojca javore për kulturën. Të gjithë transmetuesit e vendit kanë programe speciale mbi aktivitetet dhe produktet kulturore; mediat në internet kanë seksione të dedikuara për kulturën dhe po ashtu janë hapur edhe faqe të internetit si kënde për kulturën. Të gjitha këto ofrojnë mbulueshmëri tekstuale dhe pamore të vargut të gjerë të aktiviteteve kulturore si teatri, arti, muzika, filmi, letërsia dhe shumë të tjera.

Po çfarë përçon e tërë kjo përmajtje mediatike? Çfarë funksioni

4 “Politikat kulturore dhe ndarjet buxhetore për kulturën në Kosovë.” Raporthulumtues.Forum i Kulturor, Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës në Kosovë. Tetor 2014. http://www.forumikulturor.net/repository/docs/Cultural_Policies_and_Budget.pdf. Qasur së fundi më 28 janar 2016.

ndajnë për kulturën, dhe përse? Çfarë korniza dominuese përfaqësohen? Si flasin praktikat mediatike për pozicionin që duket se i është ndarë kulturës?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet njohur themelet ideologjike të mediave në raport me kulturën. Analizat që i theksojnë kornizat ideologjike bazohen në përmbajtjen e porosive të përçuara si mjet i zbulimit të sistemeve dhe vlerave mbizotëruese të besimeve brenda sistemit të mediave dhe shoqërisë në përgjithësi. Për këtë arsye përfaqësimi përmes mediave është i rëndësishëm. Nocioni se mediat e pasqyrojnë apo e prezantojnë vetëm ndonjë realitet social aktual nuk qëndron. Përfaqësimet e mediave janë të ndërtuara dhe janë pjesë e një kornize dhe ideologjie brenda të cilës përfaqësohen. Në këtë aspekt, mediat “ [...]kanë rol kyç në përcimin e ideve dhe në bërjen e tyre të rëndësishme. Tek mediat, është tendencë që vazhdimisht të shihen pamje dhe përfaqësime të njëjta.”⁵Andaj, këto

përfaqësime prodhojnë dhe kanë tendencë të rikonfirmojnë mënyra të caktuara të angazhimit dhe reagimit ndaj teksteve mediatike.

Ky raport nuk ka për qëllim të bëjë analizë teorike të këtyre raporteve. Megjithatë, do të përdoren disa prej koncepteve kryesore të politikës së përfaqësimit për të bërë një vështrim mbi rolin e mediave informative për komunikimin e kulturës. Andaj, qëllimi i këtij raporti është që të jap shembuj të praktikave dominuese të mënyrës se si mediat në Kosovë i prezantojnë, trajtojnë dhe komunikojnë prodhimet dhe aktivitetet kulturore. Kjo bëhet përmes shqyrtimit se si raportet politike, ekonomike dhe sociale, si dhe tregimet e identitetit, ndikojnë mbi qasjen e mediave.

5 “The Critical Media Project.” USC Annenberg, School for Communication and Journalism. Universi-

ty of Southern California. <http://www.criticalmediaproject.org/about/key-concepts/>. Qasur së fundi më 1 shkurt 2016.

II. Përkufizimi i mediave dhe kulturës

Me qëllim të analizimit të mediave dhe kulturës në Kosovë, ekziston nevoja për përkufizimin e domethëniesve specifike të koncepteve që do të përdoren. Media, si term, do të kufizohet për t'iu referuar mediumeve të lajmeve; do të përqendrohet në ciklin e prodhimit të informatave përmes prizmit të gazetarisë, dhe mënyrës me të cilën ato i përcjellin lajmet tek publiku i gjerë. Në këtë drejtim, raporti do të merr parasysh se si dhe çfarë përmbajtje prodhohet, cilat janë funksionet e perceptuara dhe të dëshiruara, dhe se çfarë efekte ka. Formatet specifike të mediave që trajtohen për këtë studim përfshijnë mediat e shtypura, ato elektronike dhe internetin (gazetat online, portalet, etj.). Ndërsa kultura do të trajtohet përmes dy lidhjeve kryqëzuese. Njëra është prodhimi i aktiviteteve kulturore përmes përzgjedhjes dhe promovimit mediatic, dhe tjetra është mënyra në të cilën ai aktivitetet, në veçanti tekstet mediaticke, bëhen artefakte kulturore. E para e sheh kulturën si prodhim i aktiviteteve kulturore. Rrjedhimisht, në

kuadër të këtij raporti do të shikohet se si kornizat brenda mediave i përfaqësojnë aktivitetet dhe produktet kulturore. Kjo përfshinë përzgjedhjen, trajtimin dhe paraqitjen e aktiviteteve kulturore nga ana e mediumeve të lajmeve, çka nënkuptojnë ato për kuptimin më të gjerë të kulturës në shoqëri, dhe 'përgjegjësinë' e mediave në këtë aspekt. E dyta e shikon atë se si mediat po ashtu i caktojnë role dhe vlera aktiviteteve kulturore, duke krijuar kështu një kulturë mediatikë vetvete. Rrjedhimisht, kultura mund t'i referohet teksteve mediaticke që funksionojnë si artefakte kulturore, që mund të shqyrtohen përgjatë diskurseve. Meqë do të ketë analizë të kufizuar të përmbajtjes, në raport do të jepet një skicë e disa prej çështjeve kryesore që e karakterizojnë marrëdhënien mes mediave dhe kulturës në Kosovë, dhe përmes kësaj do të ofrohet një vështrim mbi perspektivat dhe trendët interesante, të cilat mund të merren për analiza më të thella në të ardhmen.

III. Themelimi i mediave në Kosovë: Profesionalizmi, ndikimi, dhe rregulloret

Me qëllim të shqyrtimit të raportit mes mediave dhe kulturës në Kosovë, nevojitet një shpjegim se si janë themeluar ato “media të lira dhe të pavarura”. Në një anë, kjo do të mundësonte të shqyrtohen rolet e ndryshme që mediat ia kanë caktuar funksionit të tyre, në çfarë kontekstesh dhe si janë përcaktuar, mësuar, kuptuar, zbatuar dhe (ri) negociuar ato role. Në anën tjetër, po ashtu do të përfshihet një diskutim rreth forcave politike dhe ekonomike që ndikojnë mbi mënyrën se si mediat i organizojnë burimet dhe bëjnë politika redaktuese, që bëhen temë e trajtimit të kulturës nga ana e tyre.

Mediat e lajmeve kanë kaluar nëpër transformime dhe sfida të vazhdueshme në aspektin e rolit, profesionalizmit dhe cilësisë, sfidave të qëndrueshmërisë financiare dhe operimeve, raportit me publikun në kuadër të revolucionit digjital dhe në shumë aspekte të tjera. Në kontekstin e Kosovës, këto procese janë vendosur në kuadër të proceseve më të mëdha të demokratizimit gjatë 16 viteve të fundit. Në përgjithësi, mediat e lajmeve janë

vendosur në kuadër të fushëveprimit të problemeve që e karakterizojnë gazetarinë në “demokraci në tranzicion”, siç janë: praktikat gazetareske të karakterizuara me standarde profesionale të ulëta, mungesë të etikës së mediave, dhe mungesë të gazetarëve të arsimuar në mjedise të lira të mediave. Që në fillim, nevoja për reformë të mediave është bazuar në premisën se praktikat e mëparshme të mediave kanë dalë nga një censurë e sistemit socialit-komunist, e cila është pasuar nga dekada e viteve 1990-ta kur mediat shqiptare të Kosovës ka qenë kryesisht pjesë e lëvizjes së rezistencës. Së këndejmi, aktivitetet mediale kanë qenë fushë në vetvete, të udhëhequra nga ndihmesa ndërkombëtare që u realizuar në formë të rregulloreve, trajnimeve dhe donacioneve financiare⁶për me-

⁶ Sipas publikimit Vlerësimi i mediave në Kosovë, Mars 2014: Ndhima ndërkombëtare kryesisht ka ardhur përmes ndihmesës së ShBA-ve, e cila ka filluar në vitin 1998 nga Zyra për Iniciativa të Tranzicionit (ZIT), me rreth 2.25 milionë \$, të dhëna për ndihmesë mediale gjatë periudhës kohore 1998-2001. Ndhimesa tjetër ka ardhur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Bordi Ndërkombëtar për Hulumtime dhe

diat private, si dhe nga programet që kanë ndihmuar në themelimin e institucioneve të mediave publike, siç është transmetuesi publik, Komisioni i Pavarur për Media, Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës, etj.

Në një pjesë të madhe të literaturës, ku trajtohen mediat e lajmeve në demokracitë në tranzicion, përkufizohet nevoja për fuqizimin e gazetarisë në këto shoqëri si “një nga institucionet kryesore demokratike, të cilat janë thelbësore në përmirësimin e sistemit zgjedhor, të partive politike, Kuvendit, gjyqësorit dhe të degëve të tjera të shtetit, madje edhe të shoqërisë civile, si dhe ruajtja e performancës së tyre demokratike”⁷. Nga ana tjetër, sho-

Këmbime (IREX), National Endowment for Democracy (NED), Kanada, Agjencia Evropiane për Rindërtim, Friedrich Ebert Stiftung, Internews, Japoni, Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO-ja (KFOR), Norvegjia, Medienhilfe, OSBE-ja, Pressnow, Instituti për Shoqëri të Hapurit Fondacionit Soros, Suedia, Zvicra, UNDP. Gjithashtu, OSBE-ja ka rol të madh në ndihmesën e zhvillimit të mediave përmes monitorimit dhe mbikëqyrjes të sjelljes dhe praktikave të mediave. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnacx726.pdf Qasur së fundi më 31 janar 2016.

7 Nael Jebri, Václav Stetka, and Matthew Loveless. “Media and Democratisation: What is Known about the Role of Mass Media in Transitions to Democracy.” Report. Reuters Institute for the Study of Journalism.

qëria vendore dhe ndërkombëtare civile, si dhe organizatat e mediave, rregullisht zbatojnë rolin e monitorimit, vlerësimit dhe të matjes së praktikave të mediave dhe të gazetarisë në përgjithësi në kuadër të fushëveprimit të lirisë dhe pavarësisë së mediave.

Si të tilla, shkeljet e ‘lirisë së shprehjes’ dhe të ‘pavarësisë së gazetarisë’ kryesisht kanë mbizotëruar dhe formësuar diskutimin e mediave në Kosovë, dhe kohëve të fundit, edhe nevojën e vazhdueshme për krijimin e një mjedisi ku faktorët politik, ligjor dhe ekonomik nuk do të jenë pengesa për zhvillimin e mediave të lajmeve. Pasi që mediat e lajmeve kanë hyrë në treg, për shkak të varshmërisë nga tregu janë shpërfaqur edhe sfida të reja, të cilat do të shqyrtohen në pjesët e mëposhtme të këtij raporti.

Në fakt, shumë autorë e kanë konsideruar lirinë e të shprehurit dhe pavarësinë e gazetarisë si “imperativ” të profesionalizmit në University of Oxford. September 2013. https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/Media%20and%20Democratisation_0.pdf. Qasur së fundi më 26 janar 2016.

gazetari, dhe “pengesë” për shkak se “nuk ka modele të njësuara të gazetarisë[që] mund të zbatohen në mbarë botën.”⁸In the study, “Krijimi i ‘lajmeve protokollare’ në transmetuesin publik të Kosovës: Punimi Gazetaria në shoqërinë tranzicionale të rrezikuar /Journalism in a transitional risk society/,” nga autori Kenneth Andersen, vë në pah se problemi se si matet profesionalizmi mbështetet në masë të madhe në “objektivitet.” Ai thekson se derisa profesionalizimi si i lidhur me objektivitet është bërë njëri nga standartet kryesore për matjen e lirisë së shtypit dhe të pavarësisë së mediave në nivel global, duke përfshirë edhe Kosovën, “këto organizata nuk përdorin metoda të njëjta dhe shpeshherë dalin me përfundime të ndryshme.”⁹

Kjo pikëpamje është relevante pasi që aty konfirmohet se modellet e ‘importuara’ kryesisht nuk mund të shërbejnë si mekanizma të

⁸ KennethAndresen. “Producing ‘protocolnews’ in Kosovo’spublicbroadcaster: Journalism in a transitional risk society”.Conflict&CommunicationOnline, Vol. 8, No. 1, 2009.

⁹ Po aty 8.

matjes, pasi që shpesh nuk marrin parasysh kontekstin shoqëror dhe politik. Në dritën e presioneve të tregut në ekonomitë e tregut të lirë, si dhe të dinamikave ndryshuese politike në nivelin global, ridefinimi i asaj se si matet profesionalizmi është bërëçështje e debateve edhe në vendet me të traditë më të gjatë të medieve të lira.

Megjithatë, brenda qarqeve të mediave dhe të gazetarisë në Kosovë, profesionalizmi duket të jetë faktori që më së paku ka gjasë të trajtohet me rastin e matjes së performancës. Në këtë rast më shumë theks dhe vëmendje i vihet asaj se si faktorët e jashtëm pengojnë punën e mediave të lajmeve dhe më pak reflektohet apo shqyrtohet aspekti se çka duhet të trajtojë profesionalizmi në kontekstin vendor.

Faktorët e jashtëm kryesisht i atribuohen marrëdhënieve të ndërlikuara të mediave të Kosovës me pushtetin e politikës. Në fakt, mediat në Kosovë (si dhe më gjerë në regjion)shpesh janë konsideruar si aleancë mes pronarëve të mediave, politikës së qeverisë dhe bizneseve

¹⁰ - ku shpesh politika dhe bizneset janë të ndërlidhura përmes interesave të ndryshme apo politikës së shpërblimeve. Faktorët e tjerë të jashtëm që shihen si kushtëzues i performancës së mediave të lajmeve, përfshijnë edhe presionet politike, ngacmimin, zbatimin e dobët të legjislacionit për media, që gjithashtu çon në vetcensurim të gazetarëve dhe për më tepër, të gjithë këta ekzistojnë si faktorë pengues për ekzistimin e perspektivës për mjedis ku mediat do të jenë të lira.

Natyrisht, se një kornizë e shëndoshë legjislative ku funksionojnë mediat, etika e gazetarisë e pangulfatur nga kontrolli dhe presionet e pronarëve dhe një mjedis pa tentime për kufizimin e lirisë së shprehjes janë të rëndësishme në përpjekjet për krijimin e një mjedisi për punë të lirë të mediave. Por këto diskurse gjithashtu kanë përfunduar me kri-

jimin e një lloj hierarkie për atë se çka konsiderohet më shumë e rëndësishme e çka më pak.

Si të tilla, mediat në Kosovë kryesisht kanë marrë dy role: roli i parë është ai i kontrolluesit që bazohet në gazetari si një entitet përgjegjës për dhënien e informatave të drejta, të baraspeshuara dhe objektive, si dhe për ruajtjen e një kontrolli të pushteteve; dhe i dyti është roli i argëtuesit ku përfshihen të gjitha temat që jo domosdo janë politike. Në ndërkohë të dyja rolet gjithnjë e më shumë po ndikohen nga ndikimet financiare dhe politike, të cilat kanë transformuar rolin e kontrolluesit në përkrahës politik ose në kundërshtar politik, si dhe argëtuesin në sensacionalist apo në 'gjahtar të shtrigave' me tendenca moraliste.

Çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e një ekonomie konsumuese po ashtu janë të lidhura me diskurset për lirinë e mediave dhe pavarësinë e gazetarisë (të kontrollleve nga pronarët e mediave dhe ndërhyrjes politike). Brenda mjedisit të sotëm medial, mediat e lajmeve gjithnjë e më shumë po udhëhiqen

10 "Professional journalism and self-regulation. New media, Old Dilemmas in South East Europe and Turkey." United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. UNESCO 2011. <http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001908/190810e.pdf> Qasur së fundi më 1 shkurt 2016.

si biznese. Kjo ka vënë presione të dukshme tek stafi redaktues që t'u vihen pas lexuesve, shikuesve apo klikimeve, të cilat nga ana tjetër shndërrohen në reklamime dhe investime financiare. Kësaj duhet t'i shtohet edhe mungesa e sektorit të fortë të reklamimit në Kosovë,¹¹ që do të thotë se shumica e organizatave mediale “mbesin financiarisht jostabile dhe shumë pak syresh janë në gjendje të punojnë pa përkrahje nga qeveria apo bizneset e ndërlidhura me zyrtarët publikë...” dhe në ndërkohë “mundësia e sigurimit të kontratave për reklamim nga entitetet publike është e ditur se ka ndikuar në politikat redaktuese.”¹²

Kjo na sjell gjithashtu edhe aspektin e dytë të mediave, që është çështja e forcave politike dhe ekonomike, të cilat gjithashtu ndikojnë në atë se si mediat i organizojnë resurset dhe realizojnë politikat editoriale. Ky konstelacion i caktuar i afërsisë politike, kontrollit politik dhe

presioneve politike, nuk i përjash-ton mediat e Kosovës nga presio-net komerciale në rritje, brenda të cilave përmbajtja mediale udhëhiqet nga të hyrat monetare. Sa i përket përmbajtjes, kjo më pastaj përkthehet në tabloidizim të lajmeve, pasi që theksi kalon te skandali, sensacionalizmi, gazetaria e fytyrave emnente, konfliktet personale, duke e shpërfillur kështu lëndën dhe çështjen themelore.¹³

Të gjitha këto aspekte ngrisin pyetjet se cili është vendi i aktiviteteve kulturore? Nga aspekti politik, çka po ndodh me kulturën? Deri në çfarë mase mediat e perceptojnë kulturën si mjet që gjithashtu i kontribuon debatit shoqëror dhe përparimtar për një vistër çështjesh” Si e definojnë mediat “të mirën publike” dhe “interesin publik”? Cili është ndërveprimi mes kulturës, debatit publik dhe demokratizimit në njërën anë, dhe presioneve të nxitura nga tregu,

¹¹ Clifford G. Christians, Theodore L. Glasser, Denis McQuail, Kaarle Nordenstreng and Robert A. White. “Media Roles Under Challenge.” Normative Theories of the Media. University of Illinois Press 2009. <http://www.jstor.org/stable/10.5406/j.ctt1xcjws>.¹³ Qasur së fundi më 2 shkurt 2016.

¹¹ FreedomHouse, Freedom of the Press 2015. Kosovo. <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/Kosovo> Qasur së fundi më 1 shkurt 2016.

¹² Po aty 12.

nga ana tjetër?

Në bazë të përmbledhjes rrolit të mediave të lajmeve dhe të proceseve të tyre zhvillimore, në pjesën vijuese të raportit identifikohen pesë praktika kryesore për atë se si mediat e lajmeve mbulojnë aktivitetet kulturore dhe çfarë vlerash ia atribuojnë gjatë procesit.

III. Pesë praktikat e përgjithshme: si, pse dhe ku mediat e pozicionojnë kulturën?

1. Interesi publik në media

Një nga parimet bazë të gazetarisë është që t'i shërbejë të mirës publike dhe që në procesin e vendim-marrës brenda cikleve të prodhimit të lajmeve të trajtojë interesin publik. Dhënia e informatave të rëndësishme për një numër audiencash të ndryshme nga mediat e lajmeve është përkufizimi më i shpeshtë që i jepet nocionit të interesit publik.¹⁴

Në teorinë e sferës publike është zhvilluar diskutim mjaft i gjerë për mënyrat se si publiku si grup shoqëror është ndërtuar historikisht. Kritikët në përgjithësi kanë vënë në dukje atë se si nga aspekti historik publiku është trajtuar si një tërësi e vetme dhe është adresuar si “kolektivitet homogjen dhe mundësisht me një zë.”¹⁵ Mas mediat gjithashtu kanë kontribuar në krijimin e nocionit të publikut; kjo ndodh përmes vendimeve të redaksive për atë se

¹⁴ BBC Academy. The Public Interest. www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20130702112133792 Qasur së fundi më 2 shkurt 2016.

¹⁵ Stephen Coleman and Karen Ross. “The Media and the Public “Them” and “Us” in Media Discourse.” Wiley-Blackwell. 2010.

“cili është interesi më i mirë i publikut,” që sendërtohet më tej përmes ciklit të prodhimit të lajmeve, të identifikimit të çështjeve, përzgjedhjes së burimeve dhe përfshirjes së zërave. Ky proces gjithashtu përfshinë një shkallë të besimit brenda strukturave të mediave të lajmeve që edhe ato të trajtojnë se çka pret publiku prej tyre, por fillimisht, përjashton dhe marginalizon zërat e tjerë brenda shoqërisë, të cilët mund të mos jenë të përfaqësuar në konceptin mbizotërues të publikut dhe të interesit të tij.

Idetë që i shërbejnë ‘interesi publik’ gjithashtu janë duke u debatuar dhe duke u vënë në pyetje gjithnjë e më shumë brenda qarqeve profesionale të gazetarisë. Një redaktor nga gazeta britanike, the Guardian, ka filluar diskutimin përmes internetit me kolegët dhe lexuesit lidhur me atë se çka është interesi publik. Një përgjigje nga një blloger që ka fituar shpërblimin e gazetës ishte se “Shoqëria vazhdimisht është duke e ridefinuar atë se çka nënkupton interesi publik dhe se këtë duhet ta bëjë edhe në të ardhmen. Gaze-

taria duhet të jetë pjesë e këtij procesi”¹⁶, duke nënvizuar se çfarëdo tentimi për “ta definuar përfundimisht”¹⁷ mund të jetë kufizues, nëse marrim parasysh se pikëpamjet për interesin publik i nënshtrohen dhe duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme.

Në një fjalim të Martin Murit (Martin Moore), drejtor i Media Standards Trust, në Institutin e Rjter-sit për Studime të Gazetarisë, Universiteti i Oksfordit, ai përkufizoi dy elemente brenda gazetarisë në interes të publikut. Në elementin e parë gazetaria në interes publik përkufizohet si kontrolluese, rol ky që vazhdon të jetë i rëndësishëm në kërkimin e llogarisë nga mbajtësit e pushtetit; elementi i dytë, për të cilin Muri me të drejtë thotë se i kushtohet më pak vëmendje, por që meriton shumë më shumë diskutim posaçërisht “në botën e sotme të mbingarkesës me informata,” është

16 Chris Elliott. “The readers’ editor on...how should we define ‘in public interest’” The Guardian. www.theguardian.com/commentisfree/2012/may/20/open-door-definition-public-interest Qasur së fundi më 31 janar 2016.

17 Po aty 17.

përgjegjësia për të informuar, shpjeguar dhe analizuar.”¹⁸

Është mu kjo përgjegjësi që po shpërfillet dhe është e kërcënuar në kontekstin global medial, duke përfshirë edhe Kosovën, pasi që gjithnjë e më shumë interesi publik po shihet dhe po ridefinohet si “çka i intereson publikut.” Ky është gjithashtu njëri nga perceptimet kryesore që ndikon në atë se si mediat e vendosin dhe pozicionojnë kulturën.

Në Kosovë, “interesi i publikut” për një kohë është formësuar rreth projekteve më të mëdha politike dhe proceseve të konsolidimit të shtetit (siç ishte periudha 9-vjeçare nga viti 1999 si protektorat ndërkombëtar nën administrimin e UNMIK-ut, së bashku me proceset që çuan në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008). Gjatë tetë viteve të kaluara, shtetndërtimi ka rezultuar me një debat të theksuar politik, të mbushur me plotë kritika lidhur me politikanët e korruptuar, politikantë mashtrues, institucione

18 Martin Moore. “Public interest, media neglect.” British Journalism Reviews Vol. 18, No. 2, 2007, faqe 22-40. www.bjr.org.uk/data/2007/no2_moore Qasur së fundi më 2 shkurt 2016.

keqfunktionale, moszbatim të legjislacionit, ekonomi të kapur dhe mosofrimin e perspektivës ekonomike e të mirëqenies sociale. Si të tilla, mediat e lajmeve kanë konstruktuar interesin publik përmes kornizave përjashtuese. Të gjitha çështjet e tjera, siç është përfaqësimi gjinor, të drejtat e pakicave (ato etnike, seksuale, etj.), dhe veçanërisht kultura, janë sendërtuar si çështje që i shërbejnë interesit të publikut të “të tjerëve” ose “të një numri të vogël,” si jo drejtpërdrejtë relevante për trajtimin e çështjeve “reale” që kanë të bëjnë me të mirën më të madhe publike.

Kjo përputhet me perceptimin më të përhapur që ka tendenca të mbi-zotërojë se “Kosova ka nevojë të diskutojë çështjet politike më shumë se sa ato të artit dhe kulturore; dhe se problemet e Kosovës nuk janë të rrënjosura në kulturën e aq më pak në artin e saj, e as që do të tejkalohej përmes ndryshimeve kulturore.”¹⁹Këto pikëpamje e ngush-

tojnë dhe kufizojnë rolin e gazetarisë dhe mediave të lajmeve, si dhe të kulturës. Duke marrë parasysh se gazetaria dhe mediat e lajmeve kanë rol të rëndësishëm për të luajtur në Kosovë në kërkimin e llogaridhënies nga pushteti, nuk duhet të përjashtohen mënyrat, përmes të cilave aktivitetet kulturore dhe akterët nga kjo fushë i kontribuojnë procesit.

Në të kuptuarit e marrëdhënieve me pushtetin në çdo shoqëri, kultura luan rol kritik, pasi që aktivitetet kulturore gjithashtu ofrojnë mënyra të portretizimit, komentimit, sfidimit apo të provokimit të ‘sistemit’ të pushtetit, si dhe ofrojnë hapësirë për kritika politike dhe shoqërore. Megjithatë, vazhdimi i këtij përkufizimi të ngushtë të interesit publik dhe i asaj se çka i shërben të mirës publike në masë të madhe ka ndikuar në mënyrat se si perceptohen, paraqiten dhe pozicionohen lajmet në media. Thënë në përgjithësi, aktivitetet kulturore shpjegohen si ndikuese dhe në interes të “disave.”

19 Andrea Lorenzo Capussela. “Questions about, and to, Kosovo 2.0. Kosovo 2.0. [http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/1730/5yearsyellow-questions-about-and-to-kosovo-20](http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/1730/5years-yellow-questions-about-and-to-kosovo-20) ■ MEDIA DHE KULTURA

2. Kultura përmes “Gazetarisë protokollare”

Termi “gazetari protokollare” është përdorur në studime të ndryshme për të përshkruar praktikat e gazetarisë në Kosovë, të cilat kryesisht merren me mbulimin e zhvillimeve politike. Një njërin studim, për shembull, definicioni që jepet është se “gazetaria protokollare” është term negativ, që tregon se gazetari dhe organizata e lajmeve raporton thjeshtë atë që është thënë në ngjarjen e lajmeve. Me fjalë të tjera, ka të bëjë me metodat e raportimit.” Kjo praktikë është kryesisht e pranishme në mënyrën se si mediat e lajmeve e mbulojnë kulturën në Kosovë.

Në nëntor të vitit 2015, për qëllime të këtij raporti është organizuar një takim i grup të fokusit me përfaqësuesit e organizatave të pavarura të kulturës, fokus grup me redaktorët e kulturës dhe gazetarët. Në këtë diskutim, njëri prej pjesëmarrësve ia atribuojë mbulim e dobët të ngjarjeve kulturore mungesës së profesionalizmit, shkathtësive dhe

të përgatitjes së reporterëve të mediave të lajmeve për fushën e kulturës. Një faktor që është parë se ka ndikim në këtë të fundit është edhe shpërfillja e mediave për aktivitetet e kulturës. Për pjesëmarrësit e fokus grupeve, kjo ka qenë e evidente edhe në bazë të nivelit të pagave, ku reporterët e kulturës kanë nivel më të ulët të pagave, duke ardhur kështu tek dy rezultate. Në njërin anë, dekurajon gazetarët që të investojnë në punën e tyre, dhe nga ana tjetër, sot shumica e gazetarëve të kulturës e shohin këtë vendpunim si të përkohshëm dhe si hap drejt bërjes së gazetarit politik. Si e tillë, pjesa më e madhe e mbulueshmërisë së ngjarjeve kulturore ka tendencë të bazohet në komunikata për shtyp të akerëve publikë dhe të pavarur të kulturës apo është e kufizuar në mbulimin e ngjarjeve a lajmeve individuale. Natyrisht se ka përjashtime, siç është rasti me shtojcën e kulturës në gazetën Koha Ditore apo edicione të caktuara brenda programeve televizive kulturore. Por nëse analizojmë përmbajtjen del se “gazetaria protokollare” duke të jetë

metoda mbizotëruese e raportimit të aktiviteteve kulturore, e cila nuk ka fare kritikë dhe nuk shërben si platformë për nisjen e diskutimeve më të gjëra kritike.

Edhe pse të gjitha mediat e lajmeve kanë rubrikat dhe programet e kulturës, në praktikë mungon të kuptuarit se “Raportimi për kulturë gjithashtu ka të bëjë me të kuptuarit e lidhjeve mes ngjarjes mediale dhe kontekstit, të tanishmes dhe të kaluarës, artit dhe shoqërisë, publike dhe private.”²⁰ Si i tillë, roli i gazetarisë gjithnjë e më shumë ka të bëjë me “njoftimin e realitetit të ndërlikuar që përshkon ato ngjarje.” Për ta bërë këtë, mediat e lajmeve, dhe në veçanti ato të parapara për mbulimin medial, duhet të braktisin “gazetarinë protokollare” si metodë kryesore të raportimit sepse ajo vetëm zgjatë ciklin ku kulturës i hiqet mundësia për t’i shërbyer ndonjë qëllimi tjetër pos atij për ‘kalimin e kohës së lirë.’

20 CulturalReportingandCriticism.UniversityofNewYork, Graduate Program. journalism.nyu.edu/graduate/programs/cultural-reporting-and-criticism/ Qasur së fundi më 1 shkurt 2016.

3. Kultura si një ‘pushtet i butë’

Ashtu siç ndodh në shumë dimensione të jetës kosovare, arti dhe kultura gjithashtu i janë nënshtuar politikës kufizuese; fakti se Kosovën nuk e njohin 5 shtete të BE-së dhe se nuk është anëtare e OKB-së shpesh ka penguar palët kulturore dhe artistike që të përfaqësojnëvetveten në qarqet ndërkombëtare. Megjithatë, shumë artistë ia kanë arritur t’i kalojnë këto barriera në bazë të ambicies individuale. Në disa vite të kaluara, Kosova gjithashtu ia ka arritur të bëhet pjesë e rrjeteve ndërkombëtare formale. Me këtë rast janë dhënë shembuj interesant për analizën se si mediat u kanë dhënë kuptim këtyre aktiviteteve dhe në kuadër të cilave korniza të kuptimit ato ngjarje janë vendosur.

Në përgjithësi, këto aspekte mund të vendosen brenda një kuptueshmërie më të gjerë të politikës së identitetit, gjegjësisht në atë se ku lidhet prodhimi kulturor dhe artistik i Kosovës me përpjekjet dhe qëllimin e vendit që të ketë qasje dhe përfaqësim në forumet

ndërkombëtare kulturore. Në ato raste të pjesëmarrjes, akterët kulturorë dhe artistikë të Kosovës nuk flasim vetëm për punën e tyre, por bëhen përfaqësues të një entiteti më të madh, të shtetit dhe të kauzës së Kosovës.

Shembujt nga disa vite të kaluara përfshijnë pjesëmarrjen e artistit Petrit Halilaj në ekspozitën e artit pamor modern në Bienalën e Venedikut në vitin 2011, duke shënuar kështu pjesëmarrjen e parë të Kosovës në këtë ngjarje, si dhe pjesëmarrjen e artistes Flaka Haliti në këtë bienale në vitin 2015. Gjatë vitit 2014, Kosova u bë anëtare e Academy Awards, Oskarit, duke ia mundur kështu Qendrës Kinematografike të Kosovës që të dorëzojë produksionet filmike të Kosovës për përzgjedhje në Oskar. Një numër regjisorësh kosovarë ka marrë pjesë në festivale ndërkombëtare të filmit, duke fituar shpërblime dhe mirënjohje për punën e tyre. Dokufesti, Festivali ndërkombëtar i filmit dokumentar dhe të shkurtër, i cili organizohet që 14 vite, është bërë ngjarja kryesore kul-

turore në Kosovë që tërheq audienca dhe produksione profesionale vendore e ndërkombëtare. Tani së fundi, produksioni britanik-kosovar i filmit të shkurtër "Shok," i cili është prodhuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës, është përzgjedhur si një nga pesë filmat më të mirë të shkurtër nga Academy Awards, Oskar, 2016. Të gjithë këta janë shembuj të rëndësishëm sepse paraqesin kalimin nga pozita e izolimit në atë të pjesëmarrjes. Brenda diskursit të mediave të lajmeve në Kosovë, pjesëmarrja bëhet vlerë që i atribuohet kolektivitetit në kuadër të politikës së identitetit. Pasi që kjo krijon entuziazëm në rrjetet shoqërore, dhe sjell kryetijut pozitiv për Kosovën në mediat ndërkombëtare, ajo rrjedhimisht arrin një mbulueshmëri të gjerë mediale në Kosovë.

Megjithatë, thënë në përgjithësi, kritikën mungojnë, duke përfshirë ato për produksionet e teatrit, muzikës dhe filmit, si dhe për punimet e tjera pamore dhe letrare. Komentet sociale dhe politike që mund të rrjedhin bëhen të parëndësishme për

aq kohë sa ato plotësojnë aspiratën më të madhe të njohjes së Kosovës. Si të tilla, këto aktivitete kulturore, bëhen si legjitimizues dhe shpesh përdoren edhe nga përfaqësuesit politikë për t'i shërbyer diplomacisë kulturore, gjë që përfundon me zbehjen e vijave ndarëse mes shtetit, artit dhe kulturës.

I fillë ishte rasti kur në vitin 2015, kryetarja e Kosovës, Atifete-Jahjaga, hapi pavijonin e Kosovës në Bienalën e Venedikut. Në fjalën e saj të hapjes, ajo tha se: “Prania e Kosovës në ngjarjen më të rëndësishme botërore të kulturës, si një pjesëmarrëse e barabartë me vendet e tjera të botës, është dëshmi e të ariturave tona në fuqizimin e pranisë sonë ndërkombëtare. Roli i kulturës për të arritur në këtë pikë në kuadër të procesit tonë të shtetndërtimit, rimodelimit të imazhit dhe të pranisë sonë në skenën botërore ka qenë tepër i rëndësishëm dhe mbetet i fillë.”²¹ Në mediat e

21 “Fjalimi i kryetares Jahjaga në hapjen zyrtare të pavijonit të Republikës së Kosovës në Bienalën e Venedikut.”

lajmeve, punimet e akterëve individualë kulturorë dhe artistik harrohen, pasi që meritat e tyre bëhen të vlefshme vetëm pasi pranohen dhe njihen ndërkombëtarisht. Puna që nuk tërheq këtë lloj vëmendjeje, trajtohet si çështje protokollare. Thënë në përgjithësi, të gjitha aktivitetet kulturore nuk arrijnë të shndërrohen në debat kritik në media.

4. Media si kontrollues i kulturës

Roli i mediave si kontrollues përfshinë shkallën e mbikëqyrjes së funksionimit të institucioneve publike të kulturës nga ana e mediave. Aspekt thelbësor në këtë drejtim është që të sigurohemi që përmes politikave shtetërore të kulturës të mbikëqyret fuqizimi i institucioneve publike, si dhe i atyre të pavarura, dhe gjithashtu të ketë përfaqësim të një larmie të zërave.

Në përgjithësi, mediat e lajmeve në Kosovë rrallë kanë vendosur sektorin e kulturës nën vëzhgim të afërt. Në disa raporte të hartuara nga organizata Forumi Kulturor

<https://president-ksgov.net/?page=2,8,3864#> Qasur së fundi më 31 janar 2016.

është tërhequr vëmendja në atë se si konsiderohet në përgjithësi sektori i kulturës si më pak i rëndësishëm në proceset e shtetndërtimit të Kosovës. Përshembull, kur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është themeluar në kuadër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes nga Misioni i UNMIK-ut në Kosovë në vitin 2001, detyrat e kësaj Ministrie ka qenë të paraqitura në gjithsej gjashtë fjali, dhe theksi është vënë vetëm në trashëgiminë kulturore. Duke pasur parasysh se UNMIK-u kishte mbikëqyrur themelimin e të gjitha institucioneve në Kosovë, modeli dhe atribuimi i këtij Misioni se cilat fusha ishin më të rëndësishme për zhvillimin e vendit, kryesisht janë bartur në mënyrën se si institucionet e Kosovës janë organizuar.

Njëra prej mënyrave se si kjo e fundit është evidente është përmes ndarjes së buxhetit nga ana e shtetit përgjatë ministrive të linjës: Ministria e Kulturës në përgjithësi ka marrë nivelin më të ulët të buxhetit në krahasim me sektorët e tjerë. Për më tepër, si institucion kryesor

i kulturës, kësaj Ministrie i kanë munguar kapacitetet profesionale njerëzore; në “arenën politike qeverisja e kulturës përdoret si monedhë për kusuritje me rastin e finalizimit të marrëveshjeve të koalicioneve qeverisëse apo për rehatimin e figurave politike, për të cilët nuk është mundur të gjendet njërehatim më atraktiv.”²²

Së këndejmi, kjo qasje ia ka dhënë kulturës konotacionin e sektorit të parëndësishëm, që nga ana tjetër ka pasur efekt në politikat redaktuese të mediave – me fjalë të tjera, që kultura nuk meriton apo nuk kërkon monitorim të vazhdueshëm për atë se si krijohen strategjitë e kulturës (apo nëse ato madje ekzistojnë), si ndahet buxheti për institucionet publike të kulturës, deri nëçfarë mase ato krijojnë të hyra vetanake dhe investojnë në programet e tyre, cilat strategji ekzistojnë për përkrahjen e zhvillimit të qëndrueshëm si për institucionet publike të kulturës, ashtu edhe për ato të pavarura.

Thënë në përgjithësi, investimet e Ministrisë së Kulturës në pro-

22 Po aty 5.

gramet dhe projektet e kulturës kanë qenë sporadike, pa një strategji më të madhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit. Për herë të parë, një listë që ngjasonte me një strategji ishte përgatitur nga Ministria e Financave, e cila në Kornizën afatmesme të saj të shpenzimeve 2014-2016 përfshinë një listë të treguesve për matjen e performancës së Ministrisë, duke përfshirë një listë të festivaleve të dramës dhe teatrit brenda vendit; pjesëmarrjen në arenën ndërkombëtare të kulturës; koncertet filhamornike, operat dhe baletet; përkrahjen për filmat në kinematografi; numrin e ekspozitave të galerinë e arteve; bashkëpunimin brenda dhe jashtë vendit; numrin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe përkrahjen për projektet e veprave letrare dhe revistave.²³Për më tepër, në vitin 2014 buxheti i Ministrisë është rritur (edhe pse ende mjaft i ulët, prapë ka shënuar rritje prej 1.05 për qind nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës në vitin 2008, në 1.69 për qind në vitin

2014).²⁴ Në po të njëjtin vit, Ministria ka identifikuar nevojën për prioritetizimin e përkrahjes për institucione publike, dhe gjithashtu ka favorizuar përkrahjen për skenën e pavarur kulturore, si dhe pjesëmarrjen në forumet ndërkombëtare të kulturës.

Megjithatë, treguesit e Kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitin 2014 kryesisht janë të bazuar në numra, pra në një metodë sasiore të matjes së skenës kulturore dhe jo në metodë të bazuar në përmbajtje. Nevoja për një strategji më gjithëpërfshirëse ende nuk është trajtuar. Këto çështje kërkojnë një rol më të madh dhe më konsekuent kontrollues të mediave. Në përgjithësi, ky kontrollues i kulturës ka munguar apo zgjohet kur pritet ndonjë skandal. Nëse marrim parasysh sfidat e mediave që funksionojnë në bazë të tregut, kontrolluesi i kulturës (që lehtë mund të aplikohet edhe në fusha dhe çështje të tjera), është transformuar në ndjekës të skandaleve dhe tësencionit—pra, në "tabloid-

23 Po aty 5.

24 Po aty 5.

izim të lajmeve, të cilat e vendosin politikën në korniza të garës, lojërave apo të konflikteve personale, duke neglizhuar substancën e debatit dhe përmbajtjen e çështjeve.”²⁵Rrjedhimisht, këto presione tëkomercializimit“inkurajojnë një mbitheksim në aspekte triviale dhe të popullarizuara” dhe jo në aspekte thelbësore dhe informuese. Si rezultat, mungon një dialog më gjithëpërfshirës dhe kritik si mjet për arritjen e një dialogu më të madh nacional.

Një shembull i fundit në këtë drejtim janë zhvillimet që pasuan me rastin e emërimit të ministrit të ri të Kulturës pas krijimit të qeverisë së re në dhjetor të vitit 2014. Deri në mars të vitit 2015, është shpallur edhe financimi vjetor i projekteve. Kjo skemë përfshinte zvogëlime thelbësore të financimit për një numër festivalesh të pavarura, të cilët mbështeteshin në masë të madhe në subvencionet e Ministrisë.²⁶Ky vendim u bë temë e

debateve të nxehta gjatë disa javëve, ku kjo çështje vazhdon të rishfaqet në media dhe debate publike.

Në disa intervista për media, këshilltari i lartë në Ministrinë e Kulturës tha se: “ka qenë vendim i menduar mirë për ta mbajtur jetën tradicionale kulturore të Kosovës të gjallë.”²⁷Se çka do të thotë “jeta tradicionale kulturore” nga qëndrimi i Ministrisë nuk është e qartë, pasi që deri më tani nuk është paraqitur ndonjë strategji. Përzgjedhja e aktiviteteve kulturore që do të promovohen mbetet një proces jotransparent, dhe Ministria shpesh ka lëshuar deklarata kundërthënëse. Reagimet e komunitetit kulturor dhe artistik kanë qenë mjaft të zëshme lidhur me atë që dukej të ishte një ndryshim domethënës në politikën e financimit. Këtu gjithashtu u përfshi edhe vizita e disa përfaqësuesve të institucioneve të pavarura të kulturës tek kryetarja e Kosovës, ku është kërkuar themelimi i një këshilli nacional për kulturë, si dhe

25 Po aty 14.

26 JackButcher. “CulturalCuts in Kosovo: A DeeperLook.” Kosovo.www.kosovotwopointzero.com/

en/article/1654/cultural-cuts-in-kosovo-a-deeper-lookQasur së fundi më 1 shkurt 2016.

27 Po aty 25.

një strategji më e gjerë, përmes së cilës do të parandalohet marrja e vendimeve vetëm në bazë të parapëlqimeve të strukturave qeveritare brenda Ministrisë (të citat ndryshojnë me ardhjen e qeverisë së re).

Kjo ka qenë njëra nga disa zhvillimet, ku informatat konteksti dhe veprimet pasuese janë realizuar nga disa media të lajmeve.²⁸ Por, nga ana tjetër, një pjesë mjaft e madhe e mbulimit medial është bërë sipas parimit të gazetarisë “‘ai tha’, ‘ajo tha’” – duke mos materializuar këtë në një mbulueshmëri konsistente, ngjashëm me mënyrën se si bëhet për ‘çështjet më politike’. Puna e Ministrisë bëhet më shumë sipas parimeve ad hoc, varësisht prej lajmeve ose reagimeve dhe deklaratave të individëve a përfaqësuesve të ndryshëm të institucioneve dhe aktorëve të pavarur të kulturës – duke zbehur kështu rolin e kontrolluesit që duhet të angazhohet në kontrole të vazhdueshme. Mediat më nuk e

kanë përcjellë çështjen në mënyrat që do të shndërronin kërkesën për strategji të kulturës dhe planifikim e ndarje të buxhetit në zhvillim afatgjatë.

5. Fuqizimi i përkrahjes nga sektori publik

Kufizimet financiare dhe presionet e tregut ndikojnë në atë se si mediat e lajmeve e pozicionojnë kulturën dhe caktojnë prioritetet redaktuese. Në përgjithësi, ka mungesë të investimeve dhe të përkrahjes për zhvillimin e këtij sektori të mediave. Për shembull, gjatë punës në grup të fokusit, një pjesëmarrës tha se departamentet e marketingut të mediave të shtypura shpesh vendosin të shkurtojnë apo të heqin plotësisht mbulimin e kulturës për t’i bërë vend reklamave. Nga ana tjetër, në mediat e internetit, lufta konkurruese për të siguruar reklamata nga bizneset dhe sektori privat ka rezultuar në luftë për sa më shumë klikime. Kjo rrjedhimisht ka çuar në rritjen e mbulueshmërisë së tabloideve, showbizit dhe argëtim-

28 “Artistët’s’ibesojnë Ministrisë, kërkojnë këshill kombëtar për kulturë.” Kohanet.koha.net/?id=&l=50918 Qasur së fundi më 2 shkurt 2016.

it, gjë që përmes vlerës monetare ka zvogëluar dhe marginalizuar rëndësinë e kulturës.

Çështja e financimit ka nxitur diskutime të tjera në fokus grup, të cilat kanë vënë theks në llojin e përkrahjes që duhet të ekzistojë për të fuqizuar mbulueshmërinë e mediave të lajmeve për kulturë. Vëmendje e posaçme i është kushtuar rolit të institucioneve shtetërore. Ky debat është lidhur me aspekte të përgjithshme dhe me perceptime se mediat duhet të promovojnë aktivitetet e kulturës dhe se mediat publike (të cilat përkrahen me paratë e tatimpaguesve) duhet të marrin përgjegjësi më të madhe në dhënien e kontributit për arsimim, edukim dhe zhvillim të përgjithshëm të shoqërisë. Pjesëmarrësit gjithashtu menduan se programet e tanishme të kulturës janë të pamjaftueshme kur merret parasysh nevoja e fokusimit të audiencave të ndryshme, duke përfshirë edhe fëmijët. Në këtë drejtim, janë përmendur dy shembuj. Njëri ishte portali kulturor në Kroaci, Kultpunkt, përkrahësi më i madh i të cilit është Ministria e Kulturës e

Kroacisë dhe Departamenti i arsimit, kulturës dhe sportit i Komunës së Zagrebit. Shembulli tjetër ishte Radio BBC3, i cili si transmetues publik ka themeluar këtë stacion vetëm për kulturë.

Megjithatë, siç është cekur më lartë, sektori i kulturës në Kosovë kryesisht ka rënë pre e mungesës së strategjisë së përgjithshme institucionale për zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit dhe shndërrimit të tij në një sektor të qëndrueshëm. Për më tepër, zvogëlimet buxhetore të vitit 2015 tregojnë indiferencë ndaj përkrahjes për sektorin e pavarur të kulturës. Kjo sugjeron zvogëlimin e mundësive për përkrahjen e zhvillimit të programeve dhe mbulueshmërisëmediale si mënyrë për rritjen e zërave kritikë.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve ceken faktorin e konfliktit të interesit që do t'i pengonte mediat private në marrjen e përkrahjes nga shteti lidhur me fuqizimin e mbulueshmërisëmediale të kulturës. Megjithatë, në përputhje me shembullin e Radios BBC3, pjesëmarrësit në fokus grup theksuan se një radio-

stacion shtesë i RTK-së, i cili tanimë i ka 4 stacione – që do të përqendrohen vetëm në kulturë dhe art, do të ishte një pikënisje e mirë për të rritur dhe përmirësuar mbulueshmërinë e aktiviteteve kulturore në vend nga ana e mediave të lajmeve.

Po ashtu, është me rendësi të theksohet se përkrahja e sektorit publik për mediat në Evropë, siç është Franca, Finlanda, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, realizohet sipas modeleve të ndryshme – ku të gjitha këto modele pasqyrojnë sisteme dhe politika të ndryshme të mediave. Në këto vende “përkrahja e organizatave të ndryshme mediale [ekziston] për një numër arsyes, duke përfshirë ato kulturore, ekonomike dhe shoqërore, por gjithashtu kjo ndodh për shkak të shqetësimit se vetëm tregu nuk do të ofroj gazetarit me llogaridhënie të qasshme dhe debat të llojllojshëm publik, nga të cilat demokracia përfiton.”²⁹ Në disa vende zbatohet

²⁹ Rasmus Kleis Nielsen and Geert Linnebank. “Public Support for the Media: A Sex-Country Overview of Direct and Indirect Subsidies.” Report. Reuters Institute for the Study of Journalism. University of Oxford.

modeli i dyfishtë, që do të thotë se në njërin anë përkrahja bëhet përmes “një shkalle të lartë të financimit nëpërmjet pagesave për licencë për transmetuesin publik” dhe nga ana tjetër përmes “përkrahjes së gjerë për botuesit e mediave të shtypura.”³⁰ Modelet e tjera të përziera ofrojnë “nivele më të ulëta të financimit për transmetuesin publik dhe një përzierje më të stërholluar të përkrahjes indirekte dhe të drejtpërdrejtë për mediat tradicionale.”³¹ Përveç përkrahjes për mediat publike, qeveritë gjithashtu “ofrojnë përkrahje më shumë të tërthortë se sa të drejtpërdrejtë për organizatat private të mediave (vetëm Finlanda, Franca dhe Italia japin subvencione të drejtpërdrejta [...]).”³² Në rastin e Francës, gjithashtu ekziston përkrahja e sektorit publik vetëm për organizatat mediale të internetit, gjë që nuk ndodh në vendet e nga kjo listë.

August 2011. http://www.fnps.fr/Public/Article/File/DOCUMENTS/COLLOQUE/Public_support_for_Media.pdf Qasur së fundi më 2 shkurt 2016.

³⁰ Po aty 30.

³¹ Po aty 30.

³² Po aty 30.

Për më tepër, rënia e vazhdueshme e të hyrave nga reklamat për shkak të modeleve ndryshuese të mediave, “tirazhi në rënie i gazetave me pagesë dhe audienca e fragmentuar televizive,” gjithnjë e më shumë po shtron pyetjet se “çka mund të bëjë ndërhyrja publike që të përkrahë sektorin e mediave në përgjithësi dhe gazetarinë në veçanti.”³³ Në raportin e Institutit Reuters “PublicSupportfor the Media”/Përkrahja publike për mediat/, shqyrtohet modelet e këtyre vendeve të përkrahjes publike si për organizatat publike mediale, ashtu edhe për ato private. Në raport gjithashtu kërkohet që ndryshimet në mekanizmat ekzistues të përkrahjes duhet të zbatohen për të reaguar më mirë dhe për t’u siguruar që mediat e lajmeve dhe gazetaria të mbijetojnë në mënyrë cilësore. Në këtë aspekt, disa hapa tanimë janë ndërmarë. Për shembull, në vitin 2009 në Francë, qeveria dha subvencione të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për shtypin privat gjatë “një periudhe tre-vjeçare për të tra-

33 Po aty 30.

jtuar në veçanti ndikimin e krizës financiare globale.”³⁴

Ky është vetëm një shembull i izoluar, ku efektshmëria dhe mangësitë e këtyre modeleve duhet të analizohen më tej brenda kontekstit të historisë së vendit lidhur me përkrahjen publike dhe me zhvillimin e mediave. Sido që të jetë, diskutimet e ngjashme duhet të fillojnë edhe në Kosovë, gjegjësisht duhet të shikohen mënyrat e krijimit të modeleve të përkrahjes për sektorin publik për t’u siguruar që mediat e lajmeve dhe gazetaria, si themele të demokracisë, të jenë në gjendje të përmbushin përgjegjësinë e tyre. Modelet e tilla në Kosovë natyrisht se duhet të marrin parasysh perspektivën që mekanizmat e tillë do të udhëhiqeshin, kontrolloheshin dhe manovroheshin nga politika – duke përkrahur mediat e afërta me qeverinë dhe duke përjashtuar zërat kritikë. Aktualisht, fjala bie, qeveria si reklamuese në media duhet të jep prioritet reklamimit në media që kanë shikueshmëri, lexueshmëri

34 Po aty 30.

apo tirazh më të madh.³⁵ Por mungesa e të dhënave të besueshme për këto shifra i kanë dhënë qeverisë fleksibilitet më të madh që të reklamoj në media të ndryshme” dhe gjithashtu “më nuk u jap subvencione mediave lokale dhe të komunitetit,” si dhe “si qeveria, ashtu edhe bizneset kanë ndalë reklamimet e veta më mediat që kanë qenë kritikuese.” Brenda këtij konteksti, mundësitë e krijimit të modeleve transparente dhe të paanshme të përkrahjes publike për mediat duket të jenë të dobëta.

Por çështja se a duhet të diskutohen zgjidhjet dhe modelet e reja nuk duhet të vihet në pyetje. Përndryshe, mjedisi tanimë i brishtë medial do të lihet në mëshirën e tregut, duke u ballafaquar me komercializim gjithnjë në rritje, i cili jo vetëm se dukshëm po shkatërron mediat e lajmeve dhe parimet e gazetarisë, por gjithashtu është duke i kontribuar debateve polarizuese the triviale në

sferën publike.

35 International Research and Exchanges Board. IREX Europe and Eurasia Media Sustainability Index 2015. Kosovo..<https://www.irex.org/sites/default/files/2015-msi-kosovo.pdf> Qasur së fundi më 31 janar 2016.

V. Kah të shkohet tani e tutje?

Në këtë raport ceken disa kushte që ndikojnë në mënyrën se si mediat e Kosovës trajtojnë aktivitetet kulturore në vend. Thënë në përgjithësi, ajo që është e dukshme është se kultura ka rënë në një pozitë të parëndësishme në politikën shtetërore, në vendimmarrjen e editorialeve të mediave dhe në të kuptuarit e publikut. Në kuadër të konstatimeve që mund të nxirren nga ky raport, mund të ceken si në vijim: kultura është shndërruar në mjet për legjitimizim ndjenjës së ‘të genit’ dhe ‘pranimit’ të vendit; mungesa e kritikës vazhdon të mbizotërojë prodhimin kulturor; mbulueshmëria e aktiviteteve kulturore ka rënë pre e presioneve për komercializimin e mediave; nuk ekzistojnë aktualisht modele të qarta dhe të papolitizuara për përkrahjen e fuqizimit të mediave të lajmeve dhe të gazetarisë.

Objektivi ka qenë dhënia dhe caktimi i një numri të praktikave mediale, si dhe shpалosja e disa kushteve bazike që karakterizojnë dhe shpesh përcaktojnë trajtimin e përgjithshëm të kulturës nga

mediat e lajmeve. Secili koncept i mbulimit medial të kulturës i paraqitur brenda këtij raporti mund dhe duhet të elaborohet ndarazi përmes hulumtimeve të mëtejme. Si i tillë, në këtë raport ofrohet një perspektivë më e gjerë, brenda së cilës mediat dhe kultura mund të diskutohen në përgjithësi, ofrohen disa praktika ekzistuese të mbulimit të kulturës nga mediat e lajmeve që mund të shqyrtohen më tej për qëllime të kritikave, si dhe jepet një gjendje preliminare për modelet dhe praktikat që duhet të merren parasysh për shtjellim dhe përkrahje të mediave të lajmeve dhe të sektorit të kulturës.

Është me rendësi të theksohet edhe roli i arsimit dhe i edukimit, gjë e cila nuk është trajtuar në këtë raport. Kjo temë është prekur paksa gjatë fokus grupeve, të organizuara për qëllime të këtij raporti, ku është tërhequr vëmendja në nevojën e futjes së programeve arsimore brenda institucioneve shkollore (bashkëpunimi i sugjeruar ka qenë ai mes Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Kulturës) që do të

mund t'i kontribuonte zhvillimit të afërsisë së përgjithshme me aktivitetet dhe prodhimet kulturore. Roli i mediave të lajmeve në këtë proces po ashtu është theksuar në kuptimin e shpjegimit, dekonstruktimit dhe ndihmesës në krijimin e njohurisë së përgjithshme për rëndësinë e aktiviteteve kulturore në shoqëri. Kjo është arsyeja pse rritja e mbulimit të aktiviteteve kulturore duhet të shkojë tok me debatet më të gjëra shoqërore për atë se çfarë përmbajtjesh kulturore po prodhohen dhe çfarë aktiviteteve kulturore zhvillohen. Së këndejmi, nëse qëllimi është që të krijojmë një shoqëri të qëndrueshme dhe të hapur me një larmi ideshë, arsimit dhe sjellja e qytetarëve më afër kulturës janë të rëndësishme.

Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,

- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,

- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,

- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumi Kulturor synon të përmbush misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimit dhe rrjetëzimit të organizatave të pavarura në fushën e kulturës.

- Shkëmbimit dinamik të informacioneve dhe të përvojave.

- Aktiviteteve të lobimit dhe avokimit

- Trajnimeve specifike për nevojat e organizatave anëtare

- Organizimit të debateve dhe forumeve

- Bashkërenditjes së aktiviteteve artistike dhe kulturore

Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt i cili ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikaf kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013 ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, **Forumi për Zhvillim Kulturor** do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor